



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti


Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-117210
Më 2.9.2014

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur, më 2.9.2014, me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, për dhënien në shfrytëzim me qira të hapësirave-lokaleve të cilat gjenden në objektin e Kompleksit “Europa” në Prizren, dhe mori këtë

KON KL U Z I O N

- I. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, për dhënien në shfrytëzim me qira të hapësirave-lokaleve të cilat gjenden në objektin e Kompleksit “Europa” në Prizren, kështu që për këtë qëllim lejohet zhvillimi i procedurave ligjore për dhënien në shfrytëzim të këtyre hapësirave-lokale, sipas projektit ekzistues.
- II. Lokalet –hapësirat e lartcekura do të jepen në shfrytëzim duke u bazuar në Ligjin për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës nr. 04/L-144.
- III. Obligohet Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor që të procedoj me lëndën përkatëse me qëllim të zhvillimit të procedurave të mëtutjeshme ligjore.
- IV. Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor.
- V. Me këtë konkluzion të njoftohen: Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, KPF-ja, KK, si dhe Arkivi.
- VI. Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-117210
Më 2.9.2014

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur, më 2.9.2014, me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Administratës për lejimin e shpalljes së tenderit për blerjen e aparateve për shkatërrimin e letrave- grirëse letrash dhe për blerjen e skanerëve, dhe mori këtë

KON KLUZION

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Administratës për lejimin e blerjes së aparateve për shkatërrimin e letrave- grirëse letrash dhe për blerjen e skanerëve për nevojat e Administratës komunale, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Administratës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Administratës, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. Dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-120550
Më 2.9.2014

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për lejetimin e udhëtimit zyrtar për në Maqedoni dhe pagesës së mëditjeve për Urim Ukimerin, koordinator, kryetari i Komunës, më 2 shtator 2014, miratoi këtë:

V E N D I M

Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit për lejetimin e udhëtimit zyrtar të Urim Ukimerit, koordinator në DKRS, për në Mavrovë të Maqedonisë, me qëllim të pjesëmarrjes në projektin: Trajnimi i Grupit Udhëheqës të Rrjetit të Trashëgimisë Kulturore të Kosovës, që organizohet nga Komisioni Evropian. Trajnimi do të realizohet nga data 2 shtator deri me 5 shtator 2014, kështu që për këtë qëllim lejohet udhëtimi zyrtar dhe pagesa e mëditjeve, për të lartcekurin.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Neni 3


Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, i lartcekuri, si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-120558
Më 2.9.2014

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për përkrahje financiare për shënimin e manifestimit “Java e Rinisë”, kryetari i Komunës, më 2 shtator 2014, miratoi këtë:

VENDIM

Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për përkrahje financiare për shënimin dhe organizimin e manifestimit “Java e Rinisë”, i cili manifestim organizohet në bashkëpunim me Departamentin e Rinisë të Komunës së Prizrenit (DKRS) dhe Ministrisë së Kulturës, kështu që për këtë qëllim lejohen mjetet në shumën prej 2500 €.

Bartës të projektit do të jenë: Këshilli i Veprimit Rinor Lokal, Qendra Rinore, Këshilli i nxënësve të shkollave të mesme, OJQ-të rinore, etj.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-120563
Më 2.9.2014

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për lejin e mjeteve për mbështetje financiare për Klubin e Automobilizmit “Prizreni”, kryetari i Komunës më 2 shtator 2014, miratoi këtë:

V E N D I M

Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, bazuar në kërkesën e Klubit të Automobilizmit “Prizreni”, për mbështetje financiare për organizimin e garës tradicionale kodrinore të automobilizmit që mbahet me 6-7.9.2014 në dalje të qytetit të Prizrenit në rrugën Pousko, Jabllanicë, kështu që, për këtë qëllim lejohen mjetet në shumën 600 €.

Ky aktivitet do të mbahet në Prizren dhe pritet të marrin pjesë klube automobilistike nga shtetet fqinje.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe e Sportit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe e Sportit, KA “Prizreni”, si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-120567
Më 2.9.2014

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për lejimin e mjeteve për mbështetje financiare për Shoqatën e Bjeshkatarëve “Haxhi Bedredin Isaja”, kryetari i Komunës, më 2 shtator 2014, miratoi këtë:

V E N D I M

Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për mbështetje financiare për Shoqatën e Bjeshkatarëve “Haxhi Bedredin Isaja”, me qëllim të organizimit të takimeve ndërkombëtare të bjeshkatarëve “Koxha Ballkan -2014” që mbahet me 13 dhe 14 shtator 2014 në vendin e quajtur “Kopana Voda” –Prizren, kështu që, për këtë qëllim lejohen mjetet në shumën prej 1000 €.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit, si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-117210
Më 2.9.2014

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur, më 2.9.2014, me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Shëndetësisë për lejimin e shpalljes së tenderit për furnizim me dru për QMF-të dhe AMF-të, dhe mori këtë


KON KLUZION

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shëndetësisë, për lejimin e furnizimit me dru për QMF-të dhe AMF-të, ku nuk ka ngrohje qendrore, kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shëndetësisë dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shëndetësisë, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-120573
Më 2.9.2014




Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, kryetari i Komunës, me 2 shtator 2014, mori këtë

AKTVENDIM

- I. Formohet dhe emërohet Komisioni për përzgjedhjen e teksteve për monumentet kulturore-historike dhe fetare. Anëtarë të këtij komisioni, emërohen:
 - a. 1 (një) përfaqësues nga Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik,
 - b. Samir Hoxha- Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve në Prizren,
 - c. Habib Ahmeti,
 - d. Enver Baftiu,
 - e. Parim Kosova,
 - f. Shpresa Siqeca,
 - b. Vesel Hoxha,
 - c. Muhamet Çollaku,
 - d. Raif Vërmica,
 - e. Raif Kasi,
 - f. Salim Xhejlani,
 - g. Sadik Shporta.
- II. Komisioni nga pika I e këtij Aktvendimi do ta bëjë përzgjedhjen dhe harmonizimin e teksteve për monumentet kulturore-historike, fetare, të turizmit natyror, etj., të cilat paraprakisht do të siguroheshin nga institucionet relevante të Republikës së Kosovë. Me këto tekste do të shërbehen ciceronët e licencuar të Prizrenit.
- III. Për zbatimin e këtij Aktvendimi do të kujdesen: Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, si dhe të emëruarit.
- IV. Ky Aktvendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-117210
Më 2.9.2014

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 2.9.2014 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për lejimin e shpalljes së shpalljes së tenderit për shitjen e masës drunore të damkosur dhe planifikuar-ritenderim, dhe mori këtë

KONKLuzion


Miratohet propozimi i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për lejimin e shitjes së masës drunore të damkosur, kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja tenderit (ritenderim) për shitjen e masës drunore të planifikuar nga zyrtarët dhe ekspertët e APK në këto njësi menaxhuese:

1. Pashtrik – ngastra kadastrale nr. 110, në total 139.50 m³ dru, dhe
2. Pashtrik - ngastra kadastrale nr. 111, në total 193.07 m³, dru.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-117210
Më 2.9.2014

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur, më 2.9.2014, me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për lejimin e shpalljes së tenderit për blerjen e dy fotoaparateve digjitale, dhe mori këtë

KON KLUZION

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për lejimin e blerjes së dy fotoaparateve digjitale për nevojat e kësaj Drejtorie, kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-120579
Më 2.9.2014



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, për lejimin e mjeteve për mbështetje financiare për familjet strehuese, kryetari i Komunës, më 2 shtator 2014, miratoi këtë:

V E N D I M

Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, për lejimin e mjeteve për mbështetje financiare për 3 (tri) familjet strehuese në Prizren, të cilat përkujdesen për 5 (pesë) fëmijë të braktisur, kështu që, për këtë qëllim lejohen mjetet financiare në shumën prej 150 € për familje, për çdo muaj për periudhën shtator –dhjetor 2014.

Neni 2

Familjet strehuese të cilat mbështeten financiarisht me shumën dhe për periudhën e lartcekur si në nenin 1 të këtij Vendimi janë:

- a. Familja e Ramadan dhe Lendita Gashit,
- b. Familja e Valbona dhe Bedri Krasniqit, dhe
- c. Familja e Remzije dhe Fehmi Kelmendit.

Mjetet financiare lejohen në emër të njërit nga bashkëshortët e lartcekur si në germën a,b dhe c të nenit 2 të këtij vendimi.

Neni 3


Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve i Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja